



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Tiranë, më _____.2025

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen me objekt ankim kundër vendimit nr. 762, datë 15.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z.Afrim Shehu.

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u administruan, shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet dhe aktet e administruara në cilësinë e provës në funksion të shkaqeve të ankimit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në referencë të përmbajtjes së akteve të administruara dhe nivelit të provueshmërisë së tyre në lidhje me shkaqet e ankimit, parashtron si vijon:

I. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. *Lidhur me shkakun ankimor mbi burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë "Apartament me sipërfaqe 72,20 m²", me adresë në rrugën "**** ****" Tiranë, pas vlerësimit të akteve të depozituara në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, vlerësuar në harmoni me parashtrimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerësohet se:*

1.1 Subjekti i rivlerësimit, sikundër trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 11.10.2024, në Deklaratën Vetting ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri: *të ardhura nga paga si Oficer i Policisë Gjyqësore ndër vite dhe si avokat 10.4.2002-13.12.2003 dhe një vlerë prej 10.041 euro dhuratë nga *** **...depozituar në llogari datë *.7.2003...* Në deklaratën e parë dorëzuar në ILDKPKI në datë **.3.2005 në funksionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore (për deklarimin e pasurive dhe interesave private deri në vitin 2004), subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar rreth kësaj pasurie. Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti ka deklaruar se për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer si burime: (i) hua në shumën 4.000 usd marrë nga një person i afërm; (ii) të ardhura nga emigracioni dhe firmat piramidale si dhe (iii) ka deklaruar se shuma prej 10.041 euro deklaruar dhuratë nga i vëllai, ka qenë lapsus i tij.

1.2 Lidhur me analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për mbulimin me burime të ligjshme të pagesës së kështit të parë në shumën 9.040 usd datë **.9.2003, duke mbajtur në konsideratë edhe shpenzimet dhe investimet e periudhës, vlerësojmë se:

1.2.1 Për sa i përket burimit të deklaruar: *Të ardhura nga puna si avokat përgjatë periudhës **.4.2002-**.12.2003¹*, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj, ka pretenduar ndër të tjera edhe se aktiviteti i biznesit pranë të cilit ka qenë i punësuar për periudhën prill 2002 - dhjetor 2003, ka realizuar qarkullim vjetor, më të lartë se ai i deklaruar në organet tatimore, por vlera e qarkullimit vjetor të aktivitetit të avokatisë nuk është deklaruar saktë në organet tatimore, përgjegjësi kjo e punëdhënësit dhe jo e subjektit të rivlerësimit. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka depozituar në cilësinë e provës:

i. Deklarata noteriale të disa shtetasve, të hartuara gjatë vitit 2025 si dhe akte shoqëruese për sa deklaruar²;

ii. Vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, të periudhës 2002-2003 (62 vendime).

1.2.2 Nga analizimi i akteve si mësipër, konfirmohet pretendimi i subjektit mbi përfaqësimin e palëve në çështjet gjyqësore nga vetë subjekti i rivlerësimit z. Afrim Shehu, (rreth 9 raste referuar vendimeve gjyqësore dhe 4 raste referuar deklaratave noteriale dhe akteve bashkëlidhur tyre) si dhe përfaqësimi i palëve nga studio e avokatisë (ku subjekti ka qenë i punësuar) apo dhe persona të punësuar pranë kësaj studioje.

1.2.3 Bazuar në sa më sipër, vlerësohet se provohet si aktiviteti i studios së avokatisë pranë së cilës ka qenë i punësuar subjekti, ashtu dhe përfaqësimi nga ana e subjektit në çështje të ndryshme gjatë periudhës së punësimit (periudha 2002-2003), por mbeten të paprovuara pretendimet e tij *mbi masën e pretenduar* të të ardhurave të përfituara, përtej atyre të konfirmuara nga organet përgjegjëse (ISSH) si dhe ligjshmërinë e tyre referuar, kërkesave të nenit D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, vlerësohet se pretendimi i subjektit për një qarkullim të biznesit pranë të cilit ka qenë i punësuar, përtej atij të deklaruar në organet tatimore, i paraqitur vetëm gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, për qëllime të këtij procesi, mbetet i paprovuar, duke mbetur e paprovuar gjithashtu dhe e ardhura e pretenduar në vlerën 1.400.000 lekë si *pagesë në masën 20% të vlerës së paguar nga klientët e mbrojtur prej tij, apo në rastet e punës jashtë orarit dhe ditët e pushimit* (referuar kushteve të kontratës së punës datë 10.4.2002).

¹ Deklaruar në Deklaratën Vetting në shumën 2.518.333 lekë dhe në Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës të vitit 2009 në shumën 2.500.000 lekë.

² Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2025, e shtetasve *** *** dhe *** ***; Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2025 e shtetasit *** *** si dhe vendimi nr. *** datë **.5.2003 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor, Lezhë; Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2025 e shtetasit *** *** si dhe vendimi nr. *** datë **.1.2004 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit, Gjyqësor Pogradec si dhe shpjegime rreth padisë të ngritur nga *** ***; Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2025 e shtetasit *** *** si dhe vendimi nr. *** datë **.12.2003 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor, Lezhë;

1.2.4 Në vlerësim të sa më sipër, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit dhe në mbështetje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi *detyrimin e punëdhënësit për pagesën e tatimit në burim*³, vlerësohet se për qëllime të këtij procesi, si e ardhur e ligjshme nga punësimi i subjektit si avokat pranë studios së avokatisë për periudhën 2002-2003, përtej asaj të konfirmuar nga ISSH, duhet të konsiderohet vetëm përfiti në masën 20% të fitimit nga aktiviteti i studios së avokatisë, bazuar në qarkullimin e deklaruar nga ky aktivitet në organet tatimore për vitet 2002-2003. Bazuar në këtë arsyetim, e ardhura totale nga punësimi pranë studios së avokatisë vlerësohet të llogaritet në vlerën 1.537.940 lekë (shumatore e vlerës së konfirmuar nga ISSH, në shumën 956.340 lekë si dhe 20% e fitimit të studios së avokatisë, bazuar në qarkullimin e deklaruar në organet tatimore, 2.000.000 lekë për vitin 2002 dhe 1.860.000 lekë për vitin 2003, duke konsideruar si fitim 80% të xhiros së deklaruar, referuar jurisprudencës së Kolegjit).

1.2.5 Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, mbi përfitimin e të ardhurave shtesë nga zyra e noterisë (aktivitet i kunatës), me të njëjtat kushte kontraktuale si ato tek zyra e avokatisë, pretendime të ngritura në një fazë të avancuar të hetimit, vlerësohet se edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, mbetën në nivel deklarativ dhe të pa provuara me dokumentacion ligjor justifikues.

1.2.6 Për sa i përket burimit të deklaruar: *dhuratë nga vëllai *** ***, subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj ka pranuar pasaktësinë në deklarimin e këtij burimi në Deklaratën Vetting*. Transfertat nga i vëllai, sikundër trajtuar gjerësisht dhe në ankim, kanë rezultuar se janë transferuar në llogari të subjektit në datat ****4.2004** dhe ****9.2004** dhe janë tërhequr në cash nga subjekti në datë ****10.2005**, pas pagesës së kështit të parë të apartamentit, datë ****9.2003**.

1.2.7 *Sa i takon pretendimeve mbi një hua në shumën 4.000 usd*, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, marrë në vitin 2003 si pjesë e një huaje më të madhe, (prej 23.000 usd) sipas kontratës së huasë të datës ****9.2005**, nënshkruar ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe huadhënësit ***** ***, me burim të deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision si të ardhurat e shtetasit *** ***, edhe në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Kolegj, vlerësohet se ky është një pretendim i ri i subjektit të rivlerësimit, i pa deklaruar më parë në Deklaratën Vetting apo deklaratat periodike vjetore. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2009, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar se kjo hua, prej 23.000 usd, është burim krijimi për një tjetër pasuri, atë me adresë në rrugën **“*** ***, Tiranë**. Gjithashtu referuar kontratës së huasë së datës ****9.2005**, nuk specifikohet as shuma **4.000 usd**, si e dorëzuar përpara hartimit të kontratës, dhe në përmbajtjen e saj nuk pasqyrohet pretendimi i subjektit se burimi i fondeve të huazuara janë të ardhurat e shtetasit ***** *****. Në këto rrethana, kjo shumë nuk duhet të merret në konsideratë në mesin e burimeve të ligjshme dhe në analizën financiare për blerjen e apartamentit.**

³ Referohu shkresës nr. *****/**** prot., datë ****5.2024**, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas së cilës: *...Në dispozitat e nenit 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se është në përgjegjësinë e tatimpaguesit që ushtron veprimtari ekonomike që në momentin e pagesës të llogaritë, mbajë dhe derdhë në administratën tatimore, tatimin mbi të ardhurat e përfituara nga individët...*

1.2.8 Për sa i takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi të ardhurat e përfituara nga emigracioni dhe firmat piramidale, deklaruar gjatë hetimit administrativ, vlerësohet se:

(i) të ardhurat e pretenduara nga emigracioni, të padeklaruara në Deklaratën Vetting dhe në mungesë të akteve provuese, për masën e përfituar dhe ligjshmërinë e tyre, nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga neni D pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe si të tilla nuk duhet të përfshihen në mesin e burime të ligjshme në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të;

(ii) të ardhurat e pretenduara nga firmat piramidale, referuar jurisprudencës së Kolegjit⁴, edhe pse një burim i deklaruar në një fazë të avancuar të hetimit administrativ, vlerësohet se, duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka mundur të paraqesë dokumente të lëshuara nga institucione shtetërore që provojnë përfitimin nga huamarrja në firmat piramidale gjatë viteve 1996-1997⁵, të ardhurat në shumën 873.113 lekë, duhen konsideruar se plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji, për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme.

1.2.9 Në përfundim, edhe pas përfshirjes në mesin e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, të të ardhurave sipas vlerësimeve më sipër, përsëri do të rezultojë se nuk mbulohen me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D pika 3 e aneksit të Kushtetutës, shpenzimet dhe investimet e subjektit të rivlerësimit deri në datë 10.9.2003⁶, përfshi këtu dhe pagesën e këstit të parë të apartamentit, në vlerën 9.040 usd.

1.3 Lidhur me burimet që kanë shërbyer për pagesat e këstit të dytë 10.000 usd në datë 13.9.2005; këstit të tretë 1.270.000 lekë në datë **.10.2005 dhe pagesat cash për mobilimin në shumën 239.000 lekë, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të njëjtat pretendime si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, mbi disponimin e kursimeve në cash në banesë si rezultat i tërheqjeve nga llogaritë bankare përgjatë vitit 2004.

1.3.1 Sikundër trajtuar gjerësisht dhe në ankim, vlerësohet mbetën të paprovuara pretendimet e subjektit dhe shumat e tërhequra nga llogaritë bankare të subjektit në vitin 2004, nuk mund të kenë shërbyer si burim për pagesat e kësteve të tjera të apartamentit gjatë vitit 2005, për sa kohë që, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar posedim të kursimeve në cash në deklaratën vitit 2004, dorëzuar në ILDKPKI në datë 15.03.2005. Referuar kohës së tërheqjeve në cash të shumave nga llogaria bankare dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁷, vlerësohet se ato nuk duhet të konsiderohen në mesin e burimeve të ligjshme të përdorura për shlyerjen e kësteve, mbulimin e shpenzimeve shtesë/mobilimit gjatë vitit 2005 si dhe investimeve të tjera dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

1.3.2 Në analizë të situatës faktike lidhur me burimet e pretenduara për pagesat e kësteve deri në datë 2.10.2005, lidhur me pretendimin e subjektit mbi shumën e dhuruar

⁴ Referohu vendimit nr. (JR) 15/2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁵ Shkresa nr. ** prot., datë **.3.2024 e Ministrisë së Financave.

⁶ Përveç shpenzimeve të jetesës ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe depozita bankare.

⁷ Referohu vendimit nr. (JR) 8/2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

nga i vëllai Afrim Shehi, nëpërmjet transfertave në llogari bankare gjatë vitit 2004, rezulton se ato janë tërhequr në cash nga llogaria bankare nga vetë subjekti në datë **/10.2005, pas pagesave të kësteve të pasurisë, referuar mandateve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit.

1.4 Sa i përket çështjeve të trajtuara në ankim, mbi depozitim në një depozitë, të shumës 22.600 usd nga bashkëshortja e subjektit në muajin gusht 2005, çështje e cila në kuadër të ankimit të ushtruar, është e lidhur me shkakun ankimor *mbi shtrirjen e analizës financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, deri në momentet e pagesave (tetor 2005)*, subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, deklaroi se edhe këto fonde i përkasin shtetasit *** ***, janë depozituar përkohësisht nga bashkëshortja e subjektit në një depozitë bankare në emër të saj dhe më pas u tërhoqën për t'iu dhanë vëllait tjetër (*** ***)⁸.

1.4.1 Nga vlerësimi i akteve në raport me pretendimet e subjektit, vlerësohet se mbetet i paprovuar pretendimi se fondet e depozituara në depozitën bankare të bashkëshortes së tij, janë pikërisht të ardhurat e shtetasit *** *** dhe mbetën të paqarta pse këto kursime janë lënë në ruajtje të bashkëshortes së subjektit apo pse bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, nënshkroi një kontratë huaje dhe mori një hua të re nga shtetasi *** ***, me fonde po të shtetasit *** ***, ndërkohë që dispononte gati të njëjtën shumë në depozitë bankare (deri në datë **/10.2005) fonde me burim po të këtij shtetasit. Në këto kushte, në mungesë të provave për të provuar pretendimet e subjektit, shtrirja e analizës financiare deri në tetor 2005 dhe përfshirja në këtë analizë edhe e investimit në depozitë bankare në vlerën 22.600 usd, rrit pamjaftueshmërinë e konstatuar për mbulimin e pagesave të apartamentit gjatë vitit 2005 dhe shpenzimeve/ investimeve të tjera të periudhës⁹.

1.5 Duke përfunduar për pasurinë “*Apartament me sipërfaqe 72,20 m²” me adresë rruga “*** ***” Tiranë*, për sa trajtuar më sipër si dhe gjerësisht në ankimin e datës 11.10.2024, **vlerësojmë se** subjekti i rivlerësimit edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor nuk provoi burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë, ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke u ndodhur për rrjedhojë, në kushtet e nenit 61 pika 3 ligjit nr. 84/2016 si dhe ka bërë deklarime kontradiktore dhe është përpjekur të paraqesë ndryshe burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

2 Lidhur me shkakun ankimor mbi burimet e ligjshme të pasurisë “*Apartament banimi me sipërfaqe 103 m²”*, me adresë rruga “* ***”**, Tiranë.

2.1 Subjekti i rivlerësimit, sikundër trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 11.10.2024, në Deklaratën Vetting ka deklaruar: “*...sqaroj se apartamenti është blerë në vlerën 61.800 euro, ku në datën 4.6.2008 janë paguar 34.000 euro si burim nga *** ***, dhuratë ****

⁸ Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti depozitoi në cilësinë e provës shkresën nr. ***/** datë **/3.2025 të DVP Tiranë (mbi hyrje-daljet e shtetasve ***, ***, ***, ****, ****, **** dhe **** ***)⁹.

⁹ Referohu tabelës në fq. 9 të Rekomandimit të ONM-së.

*** sipas aktit noterial datë **.10.2009...”. Në të njëjtën deklaratë¹⁰ subjekti ka deklaruar dhuratë nga shtetasi *** *** në vlerën 40.000 euro. Ndërsa në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datë **.12.2009, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar këtë pasuri me vlerë 61.800 euro me burim krijimi: (i) dhuratë nga babai 40.000 euro, deklaratë noteriale datë **.10.2009; (ii) hua sipas kontratës datë **.9.2005, shuma 23.000 usd marrë nga *** ***.

2.2 Lidhur me mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, dhuruesit *** ***, për të krijuar me burime të ligjshme shumën e deklaruar të dhuruar prej 40.000 euro, në përfundim të këtij gjykimi, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur, për shumën e plotë të deklaruar të dhuruar prej 40.000 euro, por referuar akteve në dosje, provohet mundësia e kursimit nga të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, për shumën rreth 36.200 euro.

2.3 Lidhur me pretendimin e subjektit për dhurimin nga *** *** edhe të një shumë prej 9.000 euro, transferuar në llogarinë bankare të subjektit nga shtetasi *** ***, deklaruar përdorur për mobilimin e kësaj pasurie, vlerësohet i pambështetur, pasi sikundër trajtuar gjerësisht në ankim, kjo shumë nuk rezulton të jetë deklaruar më parë as nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, Deklaratën Vetting apo dhe gjatë hetimit administrativ të Komisionit, dhe as nga personi tjetër i lidhur, i vjehrrë, në deklaratën noteriale të datës **.10.2009 të shtetasit *** ***¹¹. Si subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet deklarimeve periodike vjetore dhe atij vetting, ashtu dhe personi tjetër i lidhur, *** ***, nëpërmjet deklaratës noteriale të vitit 2009, kanë konfirmuar, vetëm dhurimin e shumës prej 40.000 euro.

2.4 Lidhur me burimin tjetër të deklaruar, hua në vlerën 23.000 usd marrë nga *** ***, edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, rezultoi se nga aktet në dosje konfirmohet transferimi në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, vetëm i shumës prej 15.296 euro në datë **.10.2005 nga z. *** ***; kontrata e huasë e datës **.9.2005 është nënshkruar ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe huadhënësit shtetasit *** ***, për një hua në shumën 23.000 usd; subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision ka deklaruar se nga kjo hua, është marrë paraprakisht shuma 4.000 usd në vitin 2003 përdorur për pasurinë apartament ndodhur në Tiranë në rrugën “*** **”, ndërkohë që bashkëshortja e subjektit deklaroi huan prej 23.000 usd si burim krijimi të pasurisë apartament ndodhur në Tiranë, në rrugën “*** **”; mbetet e paqartë pse bashkëshortja e subjektit ka lidhur një kontratë huaje me shtetasin *** *** për shumën 23.000 usd në vitin 2005, hua e cila pretendohet se ka si burim të ardhurat e shtetasit *** ***, në një kohë kur bashkëshortja e subjektit, dispononte në llogarinë e saj bankare gati të njëjtën shumë, me burim të deklaruar gjatë hetimit administrativ po shtetasit *** ***. Gjithashtu edhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, mbeti e paprovuar me dokumentacion të kohës apo ndonjë evidencë tjetër, marrëdhënia midis shtetasve *** *** dhe *** ***.

¹⁰ Në rubrikën Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike, në fq. 14.

¹¹ Deklarata noteriale rezulton e hartuar pas transfertës bankare të shumës 9.000 euro kryer datë **.03.2009.

2.5 Në këto kushte vlerësohet se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me detyrimin kushtetues të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 e 32 të ligjit nr. 84/2016, ka kryer deklarime të pasakta e të paplota, si dhe ka mbajtur qëndrime kontradiktore për të dhënat e deklaruara rreth pasurive të mësipërme, të cilat bëjnë të pamundur kontrollin e plotë të organeve të rivlerësimit, edhe në variantin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit se për këtë pasuri është paguar vlera prej 51.800 euro shitësit si dhe vlera 18.000 euro shoqërisë ndërtuese, sipas mandateve të depozituara nga vetë subjekti.

2.6 Lidhur me shlyerjen e kësaj huaje gjatë vitit 2010, edhe në përfundim të këtij gjykimi, mbetën të paprovuara burimet e ligjshme të shtetasit *** ***, pasi, sikundër trajtuar gjerësisht në ankimin e datës **.10.2024 dhe parashtrimet e datës **.4.2025, shuma e deklaruara e përdorur për shlyerjen e huasë (pakësimi i depozitës bankare), rezulton se ka si burim një tjetër hua, po nga shtetasi *** ***, për të cilin nuk u provua mundësia financiare e tij, për dhënien e huave në mënyrë të vazhdueshme subjektit.

2.7 Për gjithë sa trajtuar më sipër, në lidhje me pasurinë “*Apartament banimi me sipërfaqe 103 m²*”, me adresë rruga “**** ***” Tiranë, **vlerësojmë se** subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 duke u ndodhur për rrjedhojë, në kushtet e nenit 61 pika 3 ligjit nr. 84/2016. Problematikat e konstatuara në krijimin e kësaj pasurie, impaktojnë ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga shitja e saj, deklaruar si burim për blerje të një pasurie tjetër të subjektit të rivlerësimit, atë në rrugën “**** ***”, që do të trajtohet në vijim.

3 Lidhur me shkakun ankimor mbi burimet e ligjshme të pasurive “Garazh” ndodhur në rrugën “** ***”, Tiranë**

3.1 Në Deklaratën Vetting dhe Deklaratën e Interesave Privatë para fillimit të detyrës në vitin 2009, subjekti ka deklaruar dy garazhe ndodhur në Tiranë në rrugën “**** ***” dhe si burim krijimi për to, në Deklaratën Vetting, është deklaruar: *Të ardhura nga puna ndër vite, së bashku me bashkëshorten.*

3.2 Për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe më sipër në këto bisedime, mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, viti 2009, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme blerjen e pasurive “garazh” në rrugën “**** ***” Tiranë në vitin 2009, në vlerën e plotë të tyre prej 14.000 euro. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, lidhur me këto pasuri sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 duke u ndodhur për rrjedhojë, në kushtet e nenit 61 pika 3 ligjit nr. 84/2016.

4 Lidhur me shkakun ankimor mbi burimet e ligjshme të pasurisë “Apartament me sipërfaqe 96,5 m²” me adresë rruga “** ***”, Tiranë**

4.1 Sa i përket shkaqeve të ankimit lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, lidhur me *mundësinë financiare të huadhënësit *** ***,* për të krijuar me burime të ligjshme shumat e deklaruara hua në vlerat 5.000

dollarë në vitin 2015 dhe 40.000 euro në vitin 2016, mbajti të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke ritheksuar se burimi i të ardhurave të huadhënësit *** ***, janë kursimet nga punësimi i shtetasit *** ***, për të cilin pretendoi se ka jetuar në ekonomi të përbashkët familjare me familjen e të motrës së subjektit.

4.2 Përtej pretendimeve të subjektit, sikundër trajtuar gjerësisht në ankim, rezulton se kontrata e huasë është nënshkruar midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit *** ***, nga llogaria e të cilit rezulton gjithashtu të jetë transferuar shuma e deklaruar hua prej 40.000 euro në llogari të subjektit të rivlerësimit. Bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr.84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të, të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

4.3 Referuar akteve të depozituara, të ardhurat e ligjshme të shtetasit *** ***, në vlerat rreth 80.000 - 85.000 lekë/muaj, janë të pamjaftueshme për të krijuar shumat e dhëna hua dhe për të mbuluar njëkohësisht dhe shpenzimet e tij të jetesës.

4.4 Gjithashtu, sikundër trajtuar gjerësisht dhe në ankim, referuar lëvizjeve të llogarisë bankare të huadhënësit pranë Bankës *** ***, llogari nga e cila është transferuar dhe huaja në favor të subjektit në datë **/3/2016, ka rezultuar se shuma e dhënë hua është krijuar nëpërmjet një depozitimi të vetëm në cash në datë **/1/2010 të shumës 70.000 euro, nga shtetasi *** **** në llogarinë e tij.

4.5 Subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke deklaruar se burim i të ardhurave të kësaj shume të depozituar, janë po kursimet e shtetasit *** **** dhe në krijimin e shumës 70.000 euro bën pjesë dhe kthimi i huasë marrë *** **** nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2005, (deklaruar në deklaratat periodike 2009-2010 në shumën 23.000 usd), si dhe kthimi i shumës 22.600 usd, e cila ishte e depozituar në depozitë bankare në emër të bashkëshortes së subjektit, deklaruar gjatë hetimit administrativ në Komision (trajtuar gjerësisht më sipër, për të cilën gjatë hetimit administrativ është deklaruar se në vitin 2005 i është dhënë vëllait tjetër, *** **** dhe bashkëshortes së tij).

4.6 Sa më sipër, vlerësohet se edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, pretendimet e subjektit mbetën të paprovuara, në kushtet kur nga aktet në dosje nuk ka evidenca mbi: (i) transferta nga *** **** tek *** ****, që të datojnë përpara krijimit të depozitës së *** ****, nga e cila është dhënë huaja subjektit; (ii) kthimin e shumave nga *** **** (për shumën 22.600 usd) dhe vetë subjekti i rivlerësimit (për huan në shumën 23.000 usd) tek *** ****, pretenduar si pjesë përbërëse e depozitimit prej 70.000 euro nga *** **** në llogarinë e tij në vitin 2010; (iii) kthimin e shumës 40.000 euro nga *** **** tek *** ****, etj, duke mbetur të pa provuara pretendimet e subjektit, se burim për krijimin e këtyre shumave kanë qenë pikërisht të ardhurat e shtetasit *** ****. Të vetmet evidenca mbi transferimin e fondeve nga *** **** tek *** ****, janë disa transferta bankare në një llogari të ndryshme nga ajo prej ku është dhënë vlera e huasë, që gjithsesi rezultojnë të kryera gjatë periudhës 2011-2013, pas krijimit të shumës 70.000 euro, nga e cila është dhënë dhe huaja prej 40.000 euro subjektit.

4.7 Në konkluzion të sa më sipër, **vlerësojmë se** subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament me sip. 96,5 m² me adresë në rrugën “****” Tiranë, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke u ndodhur për rrjedhojë, në kushtet e nenit 61 pika 3 ligjit nr. 84/2016.

5 *Lidhur me shkaku ankimor mbi zëra të tjerë të analizës financiare, vlerësojmë se* përsa i përket **Kursimeve në cash**, për sa trajtuar gjerësisht në analizimin e burimeve të ligjshme të pasurive të krijuara deri në vitin 2009 (apartament me vendodhje në rrugën “****”), apartament dhe dy garazhe me vendodhje në rrugën “****”), vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e deklaruara në *Deklaratën e Parë para Fillimit të Detyrës 2009*¹², përfshi këtu dhe krijimin e kursimeve në cash në vlerën e plotë të tyre, prej 15.000 euro. Rrjedhimisht, kursimet e deklaruara në shumën 15.000 euro, nuk duhet të mbarten në analizën financiare të subjektit si kursime në cash për mbulimin e shpenzimeve të mëtejshme, ndër to dhe mbulimin e shpenzimeve të mobilimit të pasurisë apartament në rrugën “****”, Tiranë. Në këto rrethana, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 duke u ndodhur për rrjedhojë, në kushtet e nenit 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5.1 *Lidhur me shpenzimet e evidentuara nga karta e kreditit*, subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, vuri në dispozicion disa akte provuese në mbështetje të pretendimeve të tij¹³, nga analiza e të cilave, vlerësohet i bazuar pretendimi se shpenzimet e kryera, janë kryesisht shpenzime që bëjnë pjesë tek produktet e shportës, e si të tilla nuk duhet të përlogariten në analizën financiare të viteve respektive, për të mos dublikuar shpenzimet e jetesës së subjektit dhe personave të lidhur me të.

5.2 *Lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar për periudhën e deklarimit 2004-2016*, vlerësuar nga Komisioni, në vlerën - 3.144.331 lekë, subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, ka prapësuar se diferenca e konstatuar për periudhën para fillimit të detyrës ka ardhur si rezultat i mosnjohjes nga ana e Komisionit e shumës 9.000 euro dhuruar nga i vjehri, për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit të apartamentit me adresë rruga “****” dhe të të ardhurave nga avokatia për periudhën 2002-2003, në shumën 944.393 lekë. Për diferencën negative të konstatuar për periudhën gjatë ushtrimit të detyrës, subjekti ka prapësuar se ajo vjen si rezultat i pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të krijimit të kursimeve cash para fillimit të detyrës, dhe impakton kursimet në cash të deklaruara në vijim¹⁴.

¹² Për sa trajtuar gjerësisht më sipër në analizimin e pasurive apartament në rrugën “****” dhe garazh me të njëjtën vendodhje.

¹³ Subjekti ka paraqitur korrespondencë elektronike mbi detajimin e disa transaksioneve blerje online.

¹⁴ Referohu parashtrimeve të subjektit fq.60 e në vijim, referuar analizës së paraqitur nga subjekti diferenca negative është në masën - 668.952 lekë para detyrës dhe - 341.283 lekë gjatë detyrës.

5.3 Për sa më sipër trajtuar gjerësisht në këto bisedime, lidhur me: (i) shumën 9.000 euro pretenduar dhuruar nga i vjehri, përtej dhurimit të deklaruar në shumën 40.000 euro; (ii) të ardhurat nga punësimi si avokat për periudhën 2002-2003, pretenduar në vlerën e deklaruar rreth 2.500.000 lekë si dhe (iii) pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, përfshi këtu dhe *kursimet në cash* në deklaratën e parë para fillimit të detyrës në vitin 2009, vlerësojmë se pretendimet e subjektit gjenden të pambështetura në akte dhe prova dhe subjekti i rivlerësimit nuk justifikon burimet e ligjshme të tij dhe personave të lidhur e të tjerë të lidhur me të për krijimin e pasurive, mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve edhe për vitet 2014-2016, për një pamjaftueshmëri financiare përtej asaj të konstatuar nga Komisioni.

5.4 Nga vendimi nr. 762/2024 i Komisionit, rezulton se edhe në skenarin më të mundshëm garantist, në të cilin Komisioni ka konsideruar të gjitha prapësimet e subjektit të rivlerësimit, sërish diferenca negative e rezultuar kalon kufijtë e proporcionalitetit dhe standartit Kushtetues të vendosur në jurisprudencën e Kolegjit. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 duke u ndodhur për rrjedhojë, në kushtet e nenit 61 pika 3 ligjit nr. 84/2016.

6 Kërkimi i ankimit

6.1 *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, mbështetur në sa më sipër, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 66, pikës 2 të nenit 4, pikës 3 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçës, të vendosë:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 762, datë 15.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu.*

DREJTUESI I PROKURORISË

Altin DUMANI

PROKURORI I AUTORIZUAR

Klodjan BRAHO